



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:239715
Datë: 02.04.2024
Numri i dokumentit: 05530861

Rev.nr.103/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Nenad Lazic dhe Muhamet Rexha, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: M. I. nga P., të cilin e përfaqëson N. H. avokat në P., sipas autorizimit, kundër të paditurës: Posta e Kosovës Sh.A., Prishtinë, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3688/2021, të datës 14.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 22.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pabazuar revizioni i paditësit: M. I. nga P., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3688/2021, të datës 14.01.2021.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr. 1539/14 të datës 14.01.2021, është vendosur: I. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit M. I. nga P., kundër të paditurës Posta e Kosovës, Sh.A., Prishtinë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e diferencës në paga dhe benefiteve të tjera si pasojë e ndryshimit të gradës së punës nga grada 6 në 4, për periudhën kontestuese prej datës ...deri më..., me kamatë ligjore 8 % e llogaritur nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive. II. Secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta të shkaktuara në këtë kontest gjyqësor.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3688/2021, të datës 14.01.2021, është vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa e paditësit M. I. nga P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr. 1539/14 i datës 14.01.2021, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet si i bazuar revizioni i paditësit, të prishet

aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ac.nr.3688/2021 i datës 21.06.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1539/14 i datës 14.01.2021 dhe lënda ti kthehet Gjykatës Themelore në Prishtinë, në rigjykim dhe rivendosje.

Me përgjigje në revizion e paditura, ka kërkuar që revizioni i paditësit të refuzohet në tërësi i pabazuar dhe të vërtetohen aktgjykimi i shkallës së parë dhe i shkallës së dytë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi më datë..., në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar kompensimin e diferencës së pagës, duke kërkuar më saktësisht në precizimin e kërkesëpadisë të bërë në seancën e datës

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.1539/14 të datës 14.01.2021, me të cilin e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se: me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka administruar këto prova: vendimin nga komisioni disiplinor të datës..., aktvendimin për sistemimin e punëtorit të datës ...me nr. ..., përgjigjen e komisionit të ankesave të datës ..., aktgjykimin PKR.nr. 510/2015 të datës 07.09.2018 të formës së prerë, kontratën e re të punës ... të datës ..., Organogramin e Postës Regjionale të Prishtinës të datës 29.07.2016, vërejtjen me shkrim për paditësin të datës ... , vërejtjen verbale për paditësin të datës ..., vendimin për largim të përkohshëm të datës

Ka shtuar se sipas provave të administruara gjykata konstaton se paditësi për shkak të veprës së lartpërmendur, me rastin e inicimit të procedurës disiplinore nga e paditura, fillimisht paditësi ka qenë i larguar përkohësisht nga vendi i punës me vendimin e datës Tutje, gjykata konstaton se me vendimin e datës ... , paditësit i është ndërprerë masa e suspendimit nga vendi i punës e cila hyn në fuqi nga data ... , konform nenit 16.4 të Kodit të Mirësjelljes së Punëtorëve, si dhe i janë shqiptuar masat: ndalim i avancimit për një vit, ulje në pozitë për dy grada dhe transferim në një zyrë tjetër postare. Nga shkresat e lëndës dhe provat e ofruara të të paditurit, gjykata konstaton se me aktvendimin mbi risistemimin e punëtorit, të datës ... , paditësi është risistemuar në punët dhe detyrat për pozitën “K.”, i cili risistemim hyn në fuqi prej datës ... , me të ardhura mujore në lartësi të gradës 4. Ky vendim përcaktohet të jetë pjesë integrale e kontratës së punës ... të datës ..., dhe nuk përcakton afat kohor të vlefshmërisë së tij.

Ka shtuar se nga sa u konstatua më lartë nga gjykata, e paditura me vendim të përgjithshëm të Komisionit Disiplinor i kishte hequr masën e suspendimit paditësit, dhe të njëjtën e ka zëvendësuar me masa më të buta ndaj tij siç është ulja në pozitë dhe transferimi në një pikë tjetër të punës. Nga elaborimet e lartcekura, meqë vendimi për risistemimin e punonjësit - paditësit nuk përmban afat të risistemimit, dhe i njëjti është nxjerrë në pajtim me dispozitat ligjore të zbatuara të Ligjit të Punës së Kosovës, dhe akteve normative të brendshme të punëdhënësit - të paditurës, duke pasur parasysh se paditësi i ka nënshkruar kontratat vijuese pa trysni dhe me vullnet, pajtim e bindje të plotë e meqë nuk ofroi prova e dëshmi bindëse për pretendimet e tij, gjykata vendosi ta refuzojë padinë e paditësit si të pa bazuar dhe të pa mbështetur në prova.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 8 të LPK-së, dhe nenit 73.1.1 lidhur me nenin 12.1.2, 84, dhe 85 paragrafi

14.4 dhe paragrafi 3 të Ligjit të Punës së Kosovës. Lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar të pabazuara pretendimet ankimore të paditësit, aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesë. Aktgjykimi i ankimuar nuk ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i qartë i kuptueshëm dhe nuk është kontradiktor me vetë veten dhe as me arsyet e aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftuara për faktet vendimtare, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave më të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuar me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale dhe ka rezultuar më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e drejt, të së drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për arsye se:

Më nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit të Punës përcaktohet se: “ Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuari. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji ”.

Me nenin 11 paragrafi 1 nga pika 1.1) deri në pikën 1.13), të këtij ligji është përcaktuar se çka duhet të përmbaj kontrata e punës.

Me nenin 55 të këtij ligji, përcaktohet se: “ 1. I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit. 2. Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës. 3. Punëdhënësi duhet t’i paguajë femrave dhe meshkujve kompensimin e njëjtë për punën e vlerës së njëjtë, kompensim i cili mbulon pagën bazë dhe shtesat e tjera. 4. Punëdhënësi duhet të nxjerrë një deklaratë për çdo pagesë dhe çdo shtesë tjetër të paguar të të punësuarve. Pagat mund të paguhen përmes transferit bankar ose me para të gatshme me ç ‘rast punëdhënësi duhet të mbajë regjistrin për pagesat e bëra. 5. Pagat në Kosovë paguhet sipas valutës zyrtare në euro (€). 6. Paga, paguhet në afatet e përcaktuara me Kontratë Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ose Kontratën e Punës, më së paku një (1) herë në muaj ”.

Me nenin 73 paragrafi 1 pika 1.3 të këtij ligji, përcaktohet se: “1. I punësuari mund të largohet përkohësisht nga puna, kur: 1.3 kryen shkelje të obligimit të punës të përcaktuara me këtë ligj”.

Me nenin 84 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji, përcaktohet se: “I punësuari është i detyruar që në vendin e punës t’iu përmbahet detyrimeve të parapara me ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës, 2. Nëse i punësuari me fajin e tij nuk i përmbush detyrat e punës apo nuk e respekton vendimin të cilin e ka nxjerrë punëdhënësi, mban përgjegjësi për shkeljen e detyrave të punës, në pajtim me ligjin, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës”.

Me nenin 85 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji, përcaktohet se: “ 1. Për shkeljen e detyrave të punës, të punësuarit do t’i shqiptohet njëra nga këto masa ndëshkuese: 1.1. vërejte me gojë; 1.2. vërejtje me shkrim; 1.3. ulje në pozitë; 1.4. suspendim të përkohshëm; 1.5. ndërprerje të marrëdhënies së punës. 2. Masat ndëshkuese, vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim dhe ulje, degradim të pozitës, do të shqiptohen për shkelje të lehta të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën e Punës”.

Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës, si dhe nga vlerësimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës edhe sipas vlerësimit të Gjykata Supreme të Kosovës, kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë kanë konstatuar dhe kanë vendosur që kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, për arsye se paditësi në këtë rast nuk e ka atakuar aktvendimin e të paditurës për risistemim në punë, mirëpo e njëjta vetëm ka kërkuar kompensimin e diferencës në paga dhe benefiteve të tjera si pasojë e ndryshimit të gradës së punës nga grada ... në ..., për periudhën kontestuese prej datës ... deri më Gjykata Supreme vlerëson se nuk mund të njihet diferenca në pagë nëse aktvendimi mbi ndryshimin e gradës është ende në fuqi, prandaj pretendimi i paditësit për kompensimin e diferencës së pagës është i pabazuar.

Përveç të cekurave në këtë rast duhet të kemi parasysh faktin se për të kërkuar kompensimin e diferencës së pagës, paraprakisht është dashur të kërkohet të anulohet vendimi me të cilin është ndryshuar diferenca e pagës-gjegjësisht aktvendimin e të paditurës për risistemim në punë, si dhe vendimin me të cilit ju është shqiptuar masa disiplinore, sepse pa anulimin e tyre nuk ka bazë ligjore që paditësi ti takojë kompensimi lidhur me këtë çështje. Andaj duke pas parasysh se paditësi nuk ka kërkuar anulimin e vendimeve të theksuara, dhe se të njëjtit janë ende në fuqi atëherë rezulton fakti se kërkesëpadia është pabazë ligjore dhe e njëjta duhet të refuzohet.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga paditësit nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ”.

Gjykata Supreme, e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimi të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme ti elaboroj secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Rev.nr.103/24, datë 22.03.2024

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi